



TRAGJEDI NË MAQEDONINË E VERIUT, 59 PERSONA HUMBIN JETËN SI PASOJË E ZJARRIT NË NJË KLUB NATE

FAQE 3



Të paktën 59 persona kanë vdekur në orët e hershme të mëngjesit të së dielës në qytetin lindor të Maqedonisë së Veriut, Koçan, pas shpërthimit të zjarrit gjatë një koncerti me mbi 1 500 pjesëmarrës

në një klub nate. Mbi 155 persona është raportuar të jenë lënduar dhe mbi 80 prej tyre janë transferuar në klinikat e Shkupit, qytet rreth 100 kilometra larg Koçanit. Sipas informacioneve, zjarri ka

shpërthyer si pasojë e mjeteve piroteknike që janë përdorur për efekt ndriçimi në koncertin e bendit ADN. Si pasojë e kësaj tragjedie, Maqedonia e Veriut ka shpallur 7 ditë zie

HAPET RRUGA PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

F. 5



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE KA SHPALLUR REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE TË 9 SHKURIT

ZJARRE TË SHUMTA NË KOSOVË, KOMUNA TË NDRYSHME PËRBALLEN ME VATRA AKTIVE

F. 6



AKTUALE



MUHAMET MAVRAJ, PUBLICIST DHE BASHKËVEPRIMTAR, NGUSHËLLON FAMILJEN THAÇI DHE MBARË KOMBIN PAS SË HAXHI THAÇIT NGA KJO BOTË

HAXHI THAÇI ËSHTË NJËRI NGA PRINDËRIT MË TË MEDHENJ TË KOMBIT



MOSZBATIMI I LIGJIT PËR QASJE NË DOKUMENTET PUBLIKE, 164 ANKESA TË QYTETARËVE

F. 3

NË SHOIPËRI QYTETARËT PËRBALLEN ME RITJE TË ÇMIMIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË AUTOMJETEVE

F. 5

SHËNDETËSIA ENDE ME LETRA E PROTOKOLLE, SISTEMI INFORMATIV SHËNDETËSOR MBETET PREMTIM ZGJEDHOR

F. 6

EKONOMI

ZRRE-ja PROPOZON SHITËNJTIMIN E RRYMËS RRETH 15 PËR QIND

F. 7

VONESA E FORMIMIT TË INSTITUCIONEVE DËMTON EKONOMINË, ZEKË KËRKON STABILITET POLITIK DHE DIALOG EFEKTIV

F. 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Tragjedi në Maqedoninë e Veriut, 59 persona humbin jetën nga zjarri në një klub nate

Të paktën 59 persona kanë vdekur në orët e hershme të mëngjesit të së dielës në qytetin lindor të Maqedonisë së Veriut, Koçan, si pasojë e shpërthimit të zjarrit gjatë një koncerti me mbi 1 500 pjesëmarrës në një klub nate. Mbi 155 persona është raportuar të jenë lënduar dhe mbi 80 prej tyre janë transferuar në klinikat e Shkupit, qytet rreth 100 kilometra larg Koçanit. Sipas informacioneve, zjarri ka shpërthyer si pasojë e mjeteve piroteknike që janë përdorur për efekt ndriçimi në koncertin e bendit ADN. Si pasojë e kësaj tragjedie, Maqedonia e Veriut ka shpallur 7 ditë zie



SHKUP, 16 MARS - Të paktën 59 persona kanë vdekur në orët e hershme të mëngjesit në qytetin lindor të Maqedonisë së Veriut, Koçan, si pasojë e shpërthimit të zjarrit gjatë një koncerti me mbi 1 500 pjesëmarrës në një klub nate, kanë njoftuar autoritetet maqedonase. Deri më tani janë identifikuar 35 viktima - prej tyre 31 nga Koçani dhe katër nga Shtipi. Mbi 155 persona është raportuar të jenë plagosur - mbi 80 prej tyre janë transferuar në klinikat e Shkupit, qytet rreth 100 kilometra larg Koçanit. Si pasojë e kësaj tragjedie, Maqedonia e Veriut ka shpallur 7 ditë zie në gjithë territorin e saj. Ministri i Brendshëm maqedonas, Pançe Toshkovski, ka thënë se sipas informacioneve të marra, zjarri ka shpërthyer si pasojë e mjeteve piroteknike që janë përdorur për efekt ndriçimi në koncertin e bendit ADN. Ai ka bërë me dije se janë lëshuar katër urdhër-arrestime, pa dhënë më shumë hollësi. Toshkovski ka thënë më herët gjatë ditës se një person është arrestuar, ndërsa agjencia e lajmeve MIA ka

raportuar se pronari i klubit është ndaluar. “Në momentin e shpërthimit të fishekzjarrit lënda duket se ka prekur tavanin, i cili është ndërtuar me material të ndezshëm dhe brenda një kohe të shkurtër është përhapur në gjithë diskotekën dhe është krijuar tym i rëndë. Brenda një kohe të shkurtër kanë arritur zjarrfikësit nga qytetet e afërta, ndërsa helikopterët e Ministrisë së Brendshme janë angazhuar për t’i transportuar të plagosurit në klinikat në Shkup”, ka thënë Toshkovski. Ai ka thënë se nëpër spitale ka të vdekur që duhet të identifikohen përmes autopsisë. “Me këtë rast, dua t’i shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta për këtë tragjedi”, ka thënë ministri. Në mesin e të vdekurve është edhe një zyrtar policor, i cili ishte pjesë e operacionit për të kryer kontrole në klube nate dhe biznese hotelerie në disa lokacione të ndryshme në Maqedoninë e Veriut. Sipas autoriteteve, operacioni ishte planifikuar për ta kontrolluar trafikimin eventual të drogave ilegale dhe praninë e të miturve nëpër klube nate. Në kuadër të veprimeve për këtë

rast, autoritetet kompetente janë duke rishikuar dokumentacionin për të kuptuar më shumë për licencën që ka pasur për të operuar ky klub nate. Zyra e Prokurorit Publik të Maqedonisë së Veriut ka thënë se një ekip prokurorësh janë duke kryer hetime. “Në këtë moment nuk mund të them saktë se si ka nisur zjarri. Jemi duke lëshuar urdhra për ta kuptuar përgjegjësinë dhe njerëzit që mund të jenë përfshirë dhe që kanë përgjegjësi. Janë disa persona në Ministrinë e Brendshme që janë duke dhënë deklaratat. Nuk mund të themi sa njerëz janë marrë në pyetje”, ka thënë kryeprokurori Ljupčo Kocevski. Kryeministri maqedonas Hristjan Mickoski ka thënë në “Facebook” se qeveria është “plotësisht e mobilizuar dhe do të bëjë gjithçka që është e nevojshme për t’u përballur me pasojat dhe për t’i

përcaktuar shkaqet e tragjedisë”. Ai ka thënë e diela është “ditë e vështirë dhe shumë e rëndë” për shtetin, i cili ka humbur kaq shumë të rinj. Ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari, ka thënë se të gjitha autoritetet shëndetësore janë mobilizuar, dhe disa të plagosur që fillimisht janë dërguar në Shtip, tani janë duke u transportuar në spitalin e Shkupit, Shën Naum Ohridski. “Po kujdesemi për të gjithë, po punojmë me të gjitha kapacitetet për të shpëtuar sa më shumë jetë që është e mundshme. Nuk do të spekuloj sa janë në gjendje kritike, por do të shkoj te Departamenti i Kirurgjisë për të marrë informacion të hollësishëm”, ka thënë Taravari. Ai e ka përmendur se ka biseduar me drejtorin e Departamentit për Transfuzion të Gjakut dhe që aktualisht nuk ka nevojë për gjak. Mëngjesin e së dielës shumë njerëz janë parë përpara objektit në Koçan, tejet të brengosur për familjarët e tyre, meqë nuk e dinë nëse janë të gjallë apo të vdekur. “Po kërkoj mbesën time. Nuk po na lejojmë të hyjmë dhe nuk e dimë ku është ajo. Telefoni i saj është duke punuar, por ajo nuk po përgjigjet. Ishim në spitalin në Koçan, në Shtip, disa njerëz i kanë dërguar në Shkup. Ndoshta është e plagosur dhe nuk mund të përgjigjet. Dikush duhet të na tregojë me urgjencë ku ta kërkojmë”, ka thënë një grua për Radion Evropa e Lirë. Ndërkohë, Kryqi i Kuq është duke përpiluar listën për t’i përcaktuar identitetet e të vdekurve.

Reagimet për incidentin

Presidentja e Kosovës, Vjosa

Osmani, u ka shprehur ngushëllime familjarëve për incidentin përmes një postimi në X, dhe ka thënë se “humbja e kaq shumë të rinjve është tragjedi përtej fjalëve”. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se është thellësisht i mërzhitur nga lajmi për tragjedinë në Maqedoninë e Veriut. “U shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjarëve që kanë humbur më të dashurit e tyre, si dhe liderëve të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut dhe gjithë shtetit në këtë periudhë të rëndë. Uroj shërim të shpejtë për të plagosurit”, ka thënë Kurti në X. Kryediplomatja e Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, ka thënë se është thellësisht e mërzhitur nga lajmi për tragjedinë. “Ngushëllime të gjithë të prekurve nga kjo tragjedi! Uroj shërim të shpejtë për të plagosurit. BE-ja ndan dhimbjen me njerëzit e Maqedonisë së Veriut”, ka shkruar Kallas në X. Ambasadorja amerikane në Maqedoninë e Veriut, Angela Aggeler, ka thënë se është zemërt hyer pas lajmit për viktimat. “Humbja e kaq shumë të rinjve në një komunitet është tragjedi e madhe. I kam ofruar ndihmë kryeministrit dhe të gjitha resurset, si dhe lutem për ata që janë në vuajtje sot”, ka thënë Aggeler përmes një postimi në X. Edhe Ambasada Amerikane në Kosovë e ka përshkruar incidentin tragjik. Ngushëllime kanë shprehur edhe presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, kryeministri Edi Rama, presidenti serb Aleksandar Vučić, kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis dhe presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky.



MAQEDONCI: KOSOVA PO NDËRTON USHTRI ME STANDARDE TË NATO-s

PRISHTINË, 16 MARS - Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri me kapacitete të plota është duke u bërë më shpejt sesa që ka qenë e planifikuar, sipas ministrit të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci.

Në një intervistë dhënë “Radios Evropa e Lirë”, ai konfirmon se numri i pjesëtarëve të FSK-së tashmë ka kaluar 4 300 dhe se brenda vitit të ardhshëm pritet të arrijë mbi 5 000.

FSK-ja është në proces të transformimit në ushtri që nga viti 2018.

Në fund të tranzicionit, më 2028, ajo parashihet t’i ketë mbi 7 500 pjesëtarë - prej tyre 5 000 aktivë, të tjerët rezervistë. “Objektivat tona po realizohen më shpejt sesa që ka qenë e planifikuar fillimisht - gjë që tregon përkushtimin tonë ndaj zhvillimit të FSK-së”, thotë Maqedonci. Sipas tij, forca ushtarake është duke u ngritur sipas standardeve të NATO-s - aleancës 32-anëtarëshe, ku Kosova mëton të anëtarësohet. Ai thotë se pjesëtarët e saj janë duke u trajnuar në akademitë ushtarake të NATO-s dhe duke zbatuar doktrinën e saj.

Për më tepër, shton Maqedonci, “të gjitha blerjet tona ushtarake realizohen nga vendet anëtare të NATO-s”. “Ky është një standard, i cili garanton pajisje cilësore dhe përputhshmëri të plotë me sistemet e aleancës”, thekson ai.

Sa i përket mbrojtjes dhe



sigurisë kombëtare, ministri vlerëson se Kosova ka kapacitete shumë më të avancuara krahasuar me disa vjet më parë.

Për shkak të ndjeshmërisë së informacionit, ai nuk jep detaje se çka prej armatimit ka vendi por, mes të tjerash, përmend “një flotë të dromëve Bayraktar” dhe “sisteme të tjera të fluturakeve pa pilotë”. “Ne kemi prokuruar sisteme të ndryshme nga vende të ndryshme dhe disa prej tyre

janë të përafërta me Javelin-in”, thotë Maqedonci, duke iu referuar sistemit kundërajror amerikan, i cili ka aftësi të avancuara kundër mjeteve të blinduara.

Vitin e kaluar Kosova ka bërë kërkesë për blerjen e 200 kundërajrorëve të tillë dhe Maqedonci thotë se aktualisht është duke u bërë pagesa e tyre.

“Departamenti i Mbrojtjes i ShBA-së i ka zbatuar të gjitha procedurat e prokurimit dhe ne jemi tashmë në fazën e ekzekutimit

të pagesave. Gjatë këtij viti pritet të arrijë një sasi e konsiderueshme e këtyre raketave”, thotë ministri Maqedonci.

Shtetet e Bashkuara e kanë mbështetur nga fillimi transformimin e FSK-së në ushtri, por jo edhe NATO-ja, e cila insiston që FSK-ja t’u përmbahet detyrave të saj fillestare, si: reagimi ndaj krizave apo mbrojtja civile.

Në këtë organizatë, ku vendimet merren në mënyrë unanime, janë katër vende që

nuk e njohin pavarësinë e Kosovës: Greqia, Spanja, Sllovakia dhe Rumania. Por, Maqedonci thotë se “shumica e vendeve anëtare të NATO-s e njohin FSK-në me mandatin e saj ushtarak”. “Ne po punojmë që në të ardhmen e afërt NATO-ja t’i njohë ndryshimet tona ligjore - çfarë do të mundësonte edhe një përfshirje më të madhe të FSK-së në operacionet e përbashkëta të NATO-s”, thotë ai.

“Për ne është thelbësore që ShBA-ja - si partnerja jonë kryesore strategjike - së bashku me vendet kryesore të NATO-s, të kontribuojnë në ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve tona mbrojtëse”, shton ministri i Mbrojtjes.

Praninë e misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR, në Kosovë, ai e përshkruan si një faktor kyç në “zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit”. “Ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë dhe t’i bashkërendojmë veprimet tona me KFOR-in dhe NATO-n për të siguruar zhvillimin e duhur të sektorit të mbrojtjes”, thekson ai.

Në vazhden e zhvillimeve të fundit gjeopolitike, ministri thotë se për katër vjetët e ardhshëm parashikohet një buxhet prej mbi 1 miliard eurosh për mbrojtjen e Kosovës. Edhe në katër vitet e kaluar buxheti për këtë sektor ka shkuar duke u rritur - nga 67.3 milionë euro në vitin 2021, në 207.8 milionë euro këtë vit.

MOSZBATIMI I LIGJIT PËR QASJE NË DOKUMENTET PUBLIKE, 164 ANKESA TË QYTETARËVE

PRISHTINË, 16 MARS - Në Agjencinë për Informim dhe Privatësi gjatë këtij viti janë paraqitur 20 ankesa të qytetarëve, ndërsa janë shqiptuar dy gjoba dhe që të dyja institucioneve private: njëra gjobë për shkak të kamerave në zhveshitore, që është rreptësisht e ndaluar dhe gjoba tjetër për shkak të përpunimit të paligjshëm të të dhënave. Por, komisionarja e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dërmaku, vë në dukje se në vitet e kaluara u janë shqiptuar gjoba edhe institucioneve publike.

Sa i përket mbikëqyrjes së Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, tani për tani numri i përgjithshëm është 164 ankesa, ndërsa këtë vit janë

shqiptuar tri gjoba: Organit Shqyrtues të Prokurimit, Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Këshillit Prokurorial. “Institucionet publike tashmë i marrin shumë seriozisht kërkesat për qasje në dokumentet publike. Ajo që vazhdimisht kemi bërë thirrje është publikimi proaktiv i informatave në mënyrë që të mos ketë edhe kërkesa për qasje e aq më pak ankesa për mohim të qasjes. Nuk është se kemi një dallim shumë të madh sa i përket transparencës në përgjithësi, mirëpo në bazë të asaj çka shohim, në bazë të numrit të ankesave mund të themi që numri i ankesave përditë dhe për muaj është rritur”, ka thënë ajo, duke shtuar se kjo tregon edhe ndërgjegjësimin e

qytetarëve që të bëjnë kërkesa në institucione për informata publike. “... por në anën tjetër ndoshta edhe për rastet kur institucionet vetë nuk u përgjigjen kërkesave të qytetarëve për t’i pasur ato informata. Gjithsesi, rezultat i krejt kësaj është se institucionet, disa edhe për shkaqe teknike, siç është niveli komunal që uebfaqet i kanë jo shumë mirë funksionale, nuk mund t’i publikojnë informatat në kohë reale”, tha komisionarja Sogojeva-Dërmaku në intervistën për Ekonomia Online.

Ajo vlerëson se në këtë rrafsh ka rritje të ndërgjegjësimit, qoftë te shoqëria, qoftë tek institucionet, duke theksuar se sa më shumë që institucionet japin informata



në uebfaqet e tyre, pra në të gjitha rrjetet e komunikimit për informim të publikut, aq më shumë do të ketë transparencë dhe aq më pak

kërkesë për qasje në dokumente publike, rrjedhimisht edhe më pak ankesa në agjencinë për mohim të qasjes.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE KA SHPALLUR REZULTATET
PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE TË 9 SHKURTIT

HAPET RRUGA PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka shpallur rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës të cilat janë mbajtur më 9 shkurt, në të cilat prin Lëvizja Vetëvendosje me mbi 390 000 vota apo 42.30 për qind. Kryetari KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka thënë se me Ligjin e ri për Zgjedhjet subjektet politike mund të ankohen në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) lidhur me këtë rezultat përfundimtar deri në 48 orë nga shpallja e tij. Kryeministri aktual Albin Kurti zotohet se do ta formojë ekzekutivin e ri, por pa treguar se si

Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniqi, ka thënë se me Ligjin e ri për Zgjedhjet subjektet politike mund të ankohen në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) lidhur me këtë rezultat përfundimtar deri në 48 orë nga shpallja e tij. PZAP-ja më pas duhet të marrë vendim brenda 96 orëve nga parashtrimi i ankesës. Radoniqi ka garantuar se në asnjë moment nuk është cenuar integriteti i votës, ani pse ka pasur vonesa në numërim të votave. Ai i ka arsyetuar vonesat duke thënë se votat janë numëruar për herë të parë siç e parasheh ligji i ri, që do të thotë se fillimisht janë numëruar votat për subjektet politike, më pas janë numëruar votat për kandidatët për deputetë në 38 qendra të numërimit, bashkë me verifikim të votave për subjekte politike.

Si tjetër arsye për vonesë ai e ka përmendur edhe platformën elektronike, e cila, sipas tij, nuk ka funksionuar si duhet, andaj zyrtarët janë detyruar të verifikojnë edhe manualisht çdo shifër, para futjes së rezultateve në sistem. “Rezultat kanë ndjekur hapat e paraparë sipas Ligjit për Zgjedhje dhe janë numëruar në transparencë të plotë”, ka thënë ai, duke u zotuar

se KQZ-ja do të organizojë panele të brendshme për të kuptuar ku ka ngecur puna dhe për t’i shmangur problemet eventuale në proceset e ardhshme zgjedhore.

Kryeministri aktual Albin Kurti, njëherësh kryetar i LV-së, zotohet se do ta formojë ekzekutivin e ri, por pa treguar se si. Zëra brenda partisë së tij përmendin mundësinë e një koalicioni me minoritetet joserbe dhe llogarisin në mbështetjen e ndonjë deputeti të partive të mëdha shqiptare, ani pse ky skenar nuk konsiderohet se do të prodhojë stabilitet.

Partitë e mëdha shqiptare kanë hedhur poshtë mundësinë e bashkëpunimit me Kurtin, madje kanë vendosur kushte edhe për arritjen e ndonjë koalicioni eventual me njëra-tjetrën.

Çfarë ndodh tash?

Brenda 30 ditëve të certifikimit të rezultateve nga KQZ-ja, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, duhet ta thërrasë mbledhjen konstituive të Kuvendit të Kosovës. Kjo mbledhje konsiderohet e mbyllur vetëm pasi të jenë zgjedhur kryetari dhe

nënkryetarët e Kuvendit. Në bazë të rezultateve preliminare, kryetari i Kuvendit do t’i takojë Lëvizjes Vetëvendosje (LV), e cila ka fituar më së shumti vota. Por, nëse kjo parti nuk e propozon dikë për kryetar, procesi do të ngrijë në vend. E nëse kryetari i Kuvendit zgjidhet, atëherë nisnin taktikat e orës për afatet e tjera.

Presidentja e vendit obligohet ta nominojë partinë fituese të zgjedhjeve mandatare për formimin e qeverisë. Ndonëse as këtu nuk ekziston një afat i saktë, vendimet në fuqi përcaktojnë që procesi duhet të zhvillohet “sa më parë që të jetë e mundur”.

Kabineti duhet t’i sigurojë votat e 61 deputetëve brenda këtij afati, por nëse kjo nuk ndodh, presidentja është e obliguar që brenda 10 ditëve t’i ftojë në konsultim edhe një herë partitë politike dhe të vendosë, sipas diskrecionit të saj, për mandatarin e re, nëse ajo ia dëshmon se i ka numrat për ta formuar qeverinë.

Edhe mandatarja e ardhshme i ka 15 ditë kohë që t’ia paraqesë Kuvendit përbërjen e kabinetit qeveritar. Nëse qeveria nuk formohet as pas 40 ditësh, presidentja duhet të shpallë dekretin për zgjedhjet e reja, që duhet të mbahen dyzet ditë prej shpalljes së vendimit.

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në Kosovë e ka miratuar në fundjavë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, në të cilin prin Lëvizja Vetëvendosje (LV) me mbi 390 000 vota apo 42.30 për qind. E dyta ka dalë Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me mbi 190 000 vota, apo 20.95 për qind, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me mbi 170 000 mijë vota, apo 18.27 për qind. Në vendin e katërt është koalicioni në mes të

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës Socialdemokrate me mbi 66 000 vota apo 7.06 për qind.

Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, ka siguruar mbi 39 000 vota apo 4.26 për qind. Me këto përqindje, LV-ja i ka siguruar 48 ulëse në Kuvendin e Kosovës, PDK-ja 24 sosh, LDK 20 vende, Lista Serbe nëntë vende dhe koalicioni AAK-Nisma tetë vende.

Të drejtë vote në këtë proces zgjedhor kanë pasur mbi 2 milionë shtetas të Kosovës, ndërsa pjesëmarrja ka qenë 46.54 për qind.

Kryetari i Komisionit Qendror të

NË SHQIPËRI QYTETARËT PËRBALLEN ME RRIJTJE TË ÇMIMIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË AUTOMJETEVE

Në Shqipëri që prej 1 janarit të vitit 2025 për rreth 900 mijë mjete rrugore do të ketë një mënyrë të re të përlllogaritjes së çmimit të sigurimit të detyrueshëm. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare përmes një rregulloreje ka shtuar disa faktorë risku që kanë sjellë rritje çmimi të sigurimit të automjeteve që shkon edhe në 20 %. Sipas Byrosë Shqiptare të Sigurimit, rritja totale është vetëm 3 %. Rregullorja që i vjen në ndihmë edhe sigurisë rrugore po shkakton debate në lidhje me disa elementë. Korrespondentja e Zërit të Amerikës në Tiranë, Mimoza Picari, sjell një analizë në lidhje me këtë çështje

TIRANË, 16 MARS - Në Shqipëri mjaft qytetarë janë përballur që prej fillimit të vitit me rritje të çmimit të sigurimit të detyrueshëm të automjeteve. Dy prej tyre i konfirmuan Zërit të Amerikës se sigurimi i automjetit këtë vit iu kushtoi gati 10 dhe 15 % më shumë se një vit më parë. Një ligj i miratuar në vitin 2021 për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit solli një qasje tjetër në këtë fushë duke i lënë hapësirë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të përpilojë një rregullore të re në shtator të vitit 2023, që shton ndjeshëm faktorët e riskut në përlllogartjen e primit të sigurimit. Më herët merreshin në konsideratë fuqia motorike e automjetit dhe viti i prodhimit, ndërsa që prej janarit të këtij viti janë shtuar disa faktorë të tjerë risku si moshja e të siguruarit, përvoja në drejtimin e mjetit motorik, përdorimi i mjetit nga

një subjekt apo individ dhe qarku i regjistrimit të mjetit. Por rregullorja e re nuk merr në konsideratë të paktën deri në vitin 2026 historikun e dëmit që e ul çmimin për atë që nuk ka kryer shkelje dhe e kundërta për atë që ka kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Në përgjigjen me shkrim për Zërin e Amerikës Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare sqaroi se hyrja në fuqi e këtij përkufizimi është shtyrë me qëllim që publiku të njihet me këtë element të ri të parashikimit ligjor. “Ky parim është thelbësor pasi individët duhet ta kenë mundësinë të njihen me normat ligjore dhe t’i planifikojnë veprimet e tyre në përputhje me ligjin, i cili duhet të jetë i qartë, i qëndrueshëm dhe i parashikueshëm. Nisur nga ky parim si dhe mundësisë së drejtuesve të mjeteve për ndërgjegjësim dhe disiplinim gjatë përdorimit të mjetit, kjo rregullore nuk ka fuqi

prapavepruese sa i përket ‘historikut të dëmeve’ të ndodhura para hyrjes në fuqi të saj”, sqaron AMF. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare shpjegoi se metodologjia e zbatuar për faktorin e riskut “historiku i dëmeve” ndryshon nga një vend në një vend tjetër në bazë të karakteristikave të tregut të sigurimeve, duke nënvizuar rëndësinë e ekuilibrit financiar të këtij tregu. “E rëndësishme është që me zbatimin e këtij faktori të ruhet ekuilibri tekniko-financiar në nivel portofoli për linjën e biznesit ku aplikohet. Sa i përket tregut të sigurimeve në Shqipëri, portofolit të autoveturave, historiku i dëmeve që merren në konsideratë është deri në tre vjet sikurse përlllogaritjet me metoda aktuariale dhe i bazuar edhe në rekomandimet e Bankës Botërore”, argumenton AMF. Byroja Shqiptare e Sigurimit i konfirmoi Zërit të Amerikës se rritja mesatare e çmimit është 3 % në total. Kryetari i Asamblesë së kësaj byroje, Kadri Morina, tha se prej tri dekadash çmimet në tregun e sigurimeve thuajse nuk kanë ndryshuar, ndërkohë që sigurimi i shëndetit për mjetet motorike është rritur ndjeshëm që prej vitit 2021. Gjithashtu, shprehet Morina, janë rritur edhe vlerat e dëmeve nga aksidentet gjatë viteve të fundit gati 40 %. “Për shembull, ju e dini si kanë shkuar çmimet e hekurit, sepse ai përdoret në serviset e makinave. Vetëm niveli i rritjes së dëmeve ka shkuar në 40 %. Pjesa kryesore e publikut ka çmimet aq sa i ka pasur, por edhe më të ulëta, kurse kategoritë sipas kubikazhit

të makinës, moshës së drejtuesit të automjetit, sipas qarqeve, vjetërsisë së makinës, kanë pësuar një trend rritje të vogël, ku e gjithë rritja në tregun e sigurimeve është 3 %. Kush ka një makinë të vogël 1 500 kubikë i është ulur siguracioni, por një makine me vlerë 400 mijë euro që ka fuqi motorike të lartë, i është rritur 20 %, por ne flasim për shtresën e gjerë të publikut”, shprehet Morina. Tregu i sigurimeve në mjaft raste ka qenë në shënjestër të kritikave se funksionon mbi bazën e marrëveshjeve të ndaluara, ku kompanitë që zotërojnë tregun fiksojnë çmimet duke penguar konkurrencën dhe dëmtuar konsumatorin. Një shqetësim të tillë e ndau me Zërin e Amerikës deputeti socialist Erjon Braçe. “Po flasim për një treg që funksionon në bazë të një marrëveshje të ndaluar. Autoriteti i Konkurrencës në këtë rast është për të garantuar konkurrencë efektive në treg që ndodh përmes verifikimeve të vazhdueshme dhe penalizimeve në rastin e marrëveshjeve të ndaluara. AMF në tregun e sigurimeve duhet të garantojë rregulla që sjellin konkurrencë. Hyrje, licencime që shtojnë konkurrencën”, thotë Braçe. AMF, i pyetur mbi këto shqetësime, tha se, sipas ligjit, nuk është në tagrin e këtij institucioni çështja e konkurrencës së lirë në tregun e sigurimeve, ndërsa Autoriteti i Konkurrencës i tha Zërit të Amerikës se gjatë viteve të fundit ka vlerësuar marrëveshjet në tregun e sigurimeve duke dhënë rekomandimet përkatëse kur e ka parë të arsyeshme. Ky

institucion sqaron se nuk ka evidentuar problematika të cilat shtrembërojnë konkurrencën, në të kundërt do të kishte ndërmarrë veprimet përkatëse ligjore. Këto tregje mbeten nën monitorim të vazhdueshëm, thotë ky institucion, në përgjigjen me shkrim. Nga ana tjetër kryetari i Asamblesë së Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Kadri Morina, i rrëzoi aludimet për marrëveshje të ndaluara mes kompanive të sigurimit dhe konfirmoi se konkurrenca në treg është e fortë. “Konkurrenca është e tmerrshme si në çdo treg tjetër. Ka raste kur na vjen klienti dhe na thotë: ma ul çmimin dy mijë lekë se ma ka dhënë kompania tjetër më lirë. Është konkurrencë, është treg i lirë”, shprehet Morina. Zëri Amerikës kreu një vëzhgim në 6 prej 8 kompanive të sigurimit që operojnë në treg. Për të njëjtin automjet çmimi fillestar i ofruar prej tyre varion nga 205 mijë deri në 216 mijë lekë të vjetra në varësi të kompanive. Megjithatë në negociata kompanitë ofruan ulje nga 5 deri në 16 mijë lekë dhe çmimi zbriti, në tre kompani 200 mijë lekë, në dy 205 mijë, në një tjetër 210 mijë lekë të vjetra. Rregullorja e re e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare “Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përlllogartjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, po shoqërohet me mjaft diskutime. Ky është viti i parë i aplikimit ndaj dhe kalkulimet e plota apo ndikimi i saj në sigurinë rrugore, sipas ekspertëve, i takojnë së ardhmes.





NDËRRON JETË BABAI I HASHIM THAÇIT

Haxhi Thaçi, babai i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka ndërruar jetë në moshën 87-vjeçare. I ndjeri ishte i shtrirë në spital prej kohësh dhe katër ditë më parë kishte marrë vizitë nga djali i tij, Hashim Thaçi, i cili ndodhet në burgun e Hagës.

REAGIMET NGA PERSONALITETET PUBLIKE

Edi Rama: Baba iku krenar, Hashim

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar në Facebook lidhur me vdekjen e Haxhi Thaçit, duke shkruar: "Baba iku krenar, Hashim".

Memli Krasniqi: Nuk u shua vetëm një njeri, por një baba që i dha Kosovës një çlirimtar

Kryetari i Partisë Demokratike të

Kosovës, Memli Krasniqi, ka shprehur dhimbjen e tij për ndarjen nga jeta të Haxhi Thaçit. "Haxhi Thaçi ishte një shtyllë e vlerave atdhetare, një njeri i urtë dhe fisnik, i cili la pas një trashëgimi të pavdekshme në historinë tonë", ka shkruar ai.

Fatmir Limaj: Baca Haxhi ishte një njeri i dashur e me vlera të larta kombëtare

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, e ka cilësuar Haxhi Thaçin si një figurë me vlera të larta kombëtare. "Ai u ballafaqua me sfida të rënda dhe pavarësisht gjithë vuajtjeve, asnjëherë nuk u dorëzua", ka shkruar Limaj.

Bedri Hamza: Një burrë i urtë dhe i dashur për të gjithë

Kandidati për kryeministër nga PDK-ja, Bedri Hamza, e ka kujtuar Haxhi Thaçin si një njeri

me shpirt të madh, i lidhur me familjen dhe atdheun. "Ai na la pas një epokë historie dhe një trashëgimi dashurie për Kosovën", ka shkruar ai.

Glauk Konjufca: U prehtë në paqe

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka shprehur ngushëllime familjes Thaçi, duke theksuar se Haxhi Thaçi do të mbetet i pranishëm në kujtimet e të gjithë atyre që e njohën.

Behgjet Pacolli: Ai e përballoi me krenari dhembjen për djalin e tij

Kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka shprehur ngushëllimet e tij, duke theksuar se Haxhi Thaçi ishte një baba që me krenari përballoi sfidat, përfshirë edhe burgosjen e djalit të tij.

Sami Lushtaku: Një burrë i urtë, me vlera familjare dhe kombëtare

Nënkryetari i Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, ka kujtuar Haxhi Thaçin si një njeri që mbeti krenar për kontributin e djalit të tij për lirinë e Kosovës.

Fadil Nura: Lamtumirë, Baca Haxhi!

Kryetari i Skenderajt, Fadil Nura, ka ngushëlluar familjen Thaçi dhe ka theksuar se ndarja nga jeta e Haxhi Thaçit është një humbje e madhe.

Artan Behrami: Lutjet e Bacës Haxhi ishin gjithmonë për lirinë e ish-krerëve të UÇK-së

Anëtari i PDK-së, Artan Behrami, ka ndarë një moment nga vizita e tij e fundit tek

Haxhi Thaçi në spital, duke thënë se ai gjithmonë lutej për lirinë e djalit të tij dhe bashkëluftëtarëve të tij.

Një Jetë e mbushur me sfida dhe qëndresë
Haxhi Thaçi do të mbetet një figurë qëndrestare, që kaloi sfida të shumta, por gjithmonë ruajti vlerat e tij familjare dhe atdhetare. Ngushëllime familjes Thaçi dhe të gjithë atyre që ndanë dhimbjen për ndarjen e tij nga kjo jetë.

REAGIMET NGA FAMILJA

Endrit Thaçi: Baci mbylli sytë i qetë pas takimit me babin

Djali i Hashim Thaçit, Endrit Thaçi, ka bërë një postim emocional, duke thënë se gjysh i tij mbylli sytë i qetë pas vizitës së djalit të tij nga Haga.



MUHAMET MAVRAJ, PUBLICIST DHE BASHKËVEPRIMTAR, NGUSHËLLON FAMILJEN THAÇI DHE MBARË KOMBIN PAS SË HAXHI THAÇIT NGA KJO BOTË

HAXHI THAÇI ËSHTË NJËRI NGA PRINDËRIT MË TË MEDHENJ TË KOMBIT



Nderime pa kufi, Bacë!



Fundi i jetës do të na gjejë dikund e disi patjetër, dhe, mirë se ardhhtë, por dinjitozë, mbi të gjitha e mbi gjithçka, në çfarëdo rrethane e çfarëdo rrethine! E di se dikush e ka më rëndë se dikush tjetër.
Haxhi Thaçi e mbylli librin e tij të jetës si njeri nga prindërit më të mëdhenj të kombit.
E thashë sa herë, për të birin e tij: “Kosova i ka disa historianë që shkruajnë historinë, por fare

pak historianë që e krijojnë atë. Ndër këta, kryesori për krijimin e historisë së re të Kosovës, është Hashim Thaçi, pa asnjë dyshim.” Për fat të keq, historia ndonjëherë tregohet e padrejtë me krijuesit e saj.
Pothuajse të gjithë që i kemi në Hagë, krahas peshës së gjyqit, vuajtën dhe po vuajnë paralelisht peshën e rëndë të familjes, sfidë pas sfide. Ja që djemtë tanë kanë një Zot që po u jep kaq

shumë qëndrueshmëri, nder dhe dinjitet, sepse asnjëherë nuk i bishtëruan sakrificës.
Hashim Thaçi dhe shokët e burgosën veten vetëm dhe vetëm që atdheu të mos burgosej. Çfarë stature botërore!
Familjes Thaçi me farefis dhe mbarë kombit i shpreh ngushëllimet më humane për ndarjen nga jeta të Bacës Haxhi!
Nderime pa kufi, Bacë! Pusho i qetë në Parajsë!

ZJARRE TË SHUMTA NË KOSOVË, KOMUNA TË NDRYSHME PËRBALLEN ME VATRA AKTIVE

PRISHTINË, 16 MARS - Javët e fundit ka pasur raportime për dhjetëra vatra të zjarreve në disa komuna të Kosovës. Fillimisht ishin raportuar zjarre në viset malore të Shtimes dhe në bjeshkët e Deçanit, ku u shkaktuan dëme të mëdha.

Gjashtë ditë më parë zjarri që shpërtheu në zonën malore të fshatrave Carralevë, Karaçicë dhe Dugë në komunën e Shtimes, shkaktoi dëme mjaft të mëdha në sipërfaqen e pyjeve. Kurse nga zjarri që shpërtheu në bjeshkët e Deçanit u dogjën mbi 40 hektarë. E me një situatë të tillë së fundmi është duke u përballur edhe komuna e Kamenicës. Nga komuna kanë bërë me dije se vatra aktive zjarri po zhvillohen në territorin e komunës së Artanës, konkretisht në zonën Gugulloc-Bushincë. “Po punohet vazhdimisht për shuarjen e zjarreve nga ekipet e zjarrfikësve,

edhe pse terreni është i papërshtatshëm. Disa vatra nuk mund të arrihen, ndaj ka nevojë për shtim të kapaciteteve dhe ndihmë me ekipe të tjera”, thuhej në njoftimin e komunës.

E përveç Kamenicës, policia përmes raportit 24-orësh ka njoftuar se raportime për zjarrvënie ka pasur edhe në disa komuna të tjera.

Një rast është raportuar në Shtërpçë, në vendin e quajtur Taraija. Dëmet nga zjarri janë shkaktuar në barishte të thata si dhe një pemishte. “Në vendin e ngjarjes njësia e zjarrfikësve e ka lokalizuar zjarrin, ndërsa deri më tani nuk kemi ndonjë ankues pasi që prona e përfshirë në zjarr është pronë private”, ka njoftuar policia.

Zjarre ka pasur edhe në dy fshatra të Lipjanit në Vershevc dhe Terbovc. Policia ka njoftuar se në Vershevc nga zjarri është

djegur një pjesë e pyllit. Njësitë relevante dhe ekipi i zjarrfikësve kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë lokalizuar zjarrin. “Vlera e dëmit nuk dihet, nuk ka të dyshuar”, kanë thënë nga policia.

Kurse në Terbovc është raportuar se nga zjarri është djegur një pjesë e fushave.

Njësitë relevante dhe ekipi i zjarrfikësve kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë lokalizuar zjarrin, përveç në disa vende ku është e pamundur intervenimi. Lidhur me rastin është njoftuar prokurori dhe kanë nisur hetimet.

Drejtori ekzekutiv i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, Genc Metaj, javën e kaluar ka deklaruar se gjendja aktuale “paraqet rrezik serioz dhe është jashtë normales”. Ai bëri me dije se deri më tani janë shkaktuar rreth 300 raste të zjarreve.



HOTI, AKUZA KQZ-së: DËSHTOI TË SIGUROJË PROCES ZGJEDHOR KREDIBIL E ME INTEGRITET



PRISHTINË, 16 MARS - Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka deklaruar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka dështuar në menaxhimin e procesit zgjedhor. Hoti ka theksuar se rezultatet e zgjedhjeve të fundit, të shpallura pas pesë javësh, tregojnë se sistemi ka dështuar në sigurimin e një procesi kredibil dhe me integritet. “Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve pas pesë javësh tregon dështimin e sistemit për menaxhimin e procesit zgjedhor. KQZ-ja ka dështuar të sigurojë një proces zgjedhor

kredibil dhe me integritet”, ka shkruar Hoti në një postim në “Facebook”. Sipas tij, ky dështim është i turpshëm, pasi Kosova kishte arritur të organizonte zgjedhje të ngjashme me standardet evropiane në të kaluarën. Kritikën e Hotit nuk ndalen këtu. Ai ka theksuar se ky dështim ka ndodhur pavarësisht nga kultura e lartë demokratike që qytetarët e Kosovës treguan në ditën e zgjedhjeve: “Kjo është për keqardhje pas kulturës demokratike të treguar nga qytetarët në ditën e zgjedhjeve”.

Hoti ka përmendur edhe çështjen e votave nga diaspora, për të cilat ka hedhur dyshime, sidomos për votimin në ambasada dhe përmes postës. Ai ka theksuar se: “Njollë e këtyre zgjedhjeve do të mbetet edhe çështja e votave nga diaspora, për të cilat janë hedhur dyshime si për votimin në ambasada/konsullata, ashtu edhe për votimin me postë.” Hoti ka shtuar se këto dështime nuk i ka merituar Kosova dhe se për këtë situatë duhet të mbajë përgjegjësi jo vetëm KQZ-ja, por edhe ata që janë përgjegjës politikisht dhe ligjërisht.

SHËNDETËSIA ENDE ME LETRA E PROTOKOLLE, SISTEMI INFORMATIV SHËNDETËSOR MBETET PREMTIM ZGJEDHOR

PRISHTINË, 16 MARS - Funksionalizimi i sistemit unik dhe të integruar të informimit shëndetësor ishte një ndër premtimet me të cilat Lëvizja Vetëvendosje kryesonte plan-programin me të cilin kishte ardhur në pushtet. Katër vjet pas, qendrat mjekësore vazhdojnë të mbështeten në dokumentet klasike, të shkruara me dorë, ngaqë sistemi aktual bazik “B HIS” ka probleme të vazhdueshme. “Fatkeqësisht nuk është e kompletuar tërësisht, se po të ishte do të veprime ndryshe, duke marrë parasysh se ka rënie të shpeshta të sistemit në gjithë Kosovën. Për shkak të ngecjeve ne obligohemi të punojmë në formë klasike, me letra e protokolle, e kur punon i

fusim në sistem. Ka periudha kur punon brenda ditës, por ka periudha që bie deri në 10 herë brenda ditës. Është ngarkesë e pacientëve, e stafit, duhet të kthehet në funksion”, ka thënë Bujar Gashi, drejtor i QKMF-së në Prishtinë.

Po të vihej në praktikë, efekti, sipas Gashit, do ta lehtësonte dinamikën e institucioneve shëndetësore. “Jashtëzakonisht do ta lehtësonte punën, sepse puna do të përgjysmohej për shkak se SISH e shkurton kohën e punës. Çka bisedojmë me pacientët nga anamneza, ekzaminimi fizik, diagnoza dhe referimi bëhet krejt në kompjuter çka është më e lehtë. Minimizohen gabimet dhe s’ka gabime në barnatore e pritjet do

të jenë shumë më të vogla”, ka shtuar Gashi.

Arsyeja kryesore, sipas Besim Kodrës nga Shoqata për Mbrojtjen e Pacientëve në Kosovë, është mungesa e vullnetit të institucioneve për të treguar transparencë. E sipas tij, funksionalizimi i tërësishëm i Sistemit Informativ Shëndetësor nuk mund të ëritet në një të ardhme të afërt.

Televizioni “Dukagjini” ka pyetur Ministrinë e Shëndetësisë rreth fazës së procesit për funksionalizimin e SISH por e njëjta, siç ndodh rëndom, nuk është përgjigjur. Funksionalizimi i sistemit në fjalë mbetet parakusht për krijimin e Fondit për Sigurime Shëndetësore.



ZRRE-ja propozon shtrenjtimin e rrymës rreth 15 për qind

PRISHTINË, 16 MARS - Zyra e Rregullatorit për Energji Elektrike në Kosovë (ZRRE) njoftoi të premten se ka propozuar shtrenjtimin e çmimit të energjisë elektrike në vend për rreth 15 për qind muajin e ardhshëm. Rregullatori i energjisë tha në “Facebook” se, bazuar në rezultatet e raportit të tij konsultativ për të hyrat maksimale të lejuara, rritja mesatare e tarifave për konsumatorët pritet të tjerë 15 për qind dhe ftoi konsumatorët për konsultim publik. Ajo tha se komentet dhe sugjerimet e tyre do t'i pranojë deri më 28 mars, para se bordi të marrë vendim përfundimtar për shtrenjtimin e rrymës. ZRRE-ja bën shqyrtimin dhe caktimin e përvitshëm të tarifave të rrymës të cilat shpallen çdo 1 prill dhe vlejné deri më 31 mars të vitit pasues. Javë më parë tri kompanitë e sektorit të energjisë në Kosovë i kërkuan rregullatorit të energjisë rritjen e çmimit të tarifave të rrymës. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut [KOST], Kompania për Distribuim të Energjisë Elektrike në Kosovë [KEDS] dhe Kompania Kosovare për

Furnizim me Energji Elektrike [KESCO], kërkuan ngritjen e çmimit të tarifave të rrymës për shkak të importit të energjisë elektrike. Vitin e kaluar ZRRE-ja e uli çmimin për konsumatorët komercialë dhe industrialë për 3 për qind, por një vit më herët, më 2023, tarifat u rritën për 15 për qind për të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Aktualisht, për konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë brenda një muaji, çmimi i rrymës gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat, ndërsa për ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë, pjesa mbi këtë u llogaritet me çmim prej 14.45 centësh. Nga ora 22:00 deri në 7:00 të mëngjesit, çmimi për kilovat është 3.34 centë për ata që shpenzojnë deri në 800 kilovatë dhe 6.81 centë për ata që shpenzojnë më shumë. Në fillim të marsit, ish-ministri i Energjisë, Ethem Çeku, paralajmëroi për Radion Evropa e Lirë se rritja e çmimit të energjisë elektrike ishte e pashmangshme. Në intervistën për REL-in ai tha se për ta zvogëluar sasinë e importit, Kosova duhet ta rrisë prodhimin vendor, sidomos



përmes energjisë alternative. Kosova nuk arrin t'i plotësojë nevojat e mbi 1.6 milion banorëve të saj me rrymë, andaj edhe importon nga bursat e huaja. Vendi ka kapacitet të prodhojë rreth 800 megavate rrymë në orë, ndërsa nevojat e tij, në ditë dimri, arrijnë deri në 1 300 megavate në orë. Një nga arsytet për nënprodhim është vjetërsia me dekada e termocentraleve Kosova A dhe Kosova B. Aktualisht mbi 20 për qind e energjisë elektrike në Kosovë

prodhohet nga burimet alternative, si: hidrocentralet, centralet me erë dhe panelet me diell. Autoritetet e Kosovës kanë thënë më herët se synimi është që pas vitit 2031, 35 për qind e energjisë elektrike të gjenerohet nga këto burime. Strategjia për Energji 2022-2031 e Kosovës përqendrohet tek investimet në energji të ripërtëritshme, por një pjesë përfshin edhe Termocentralin Kosova A, përkatësisht investimet në së paku një njësi apo bllok të tij.

DhTIK kërkon nga qeveria Kurti të ndërhyjë dhe mos të lejojë rritjen e çmimit të energjisë

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë në një reagim ka thënë se ka pritur me shqetësim të madh paralajmërimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për rritjen e çmimit të rrymës për 15 %. Në reagim thuhet se ky vendim konsiderohet se është bërë pa konsulta të duhura me bizneset dhe pa një analizë të duhur për pasojat që mund të sjellë kjo rritje te prodhuesit vendës. “Rritja e sërishme prej 15 % po ndodh vetëm dy vjet pasi një rritje e tillë ishte bërë nga ZRRE-ja dhe pasojat e saj vazhdojnë të jenë të pranishme te bizneset. Një ngritje e tillë e çmimit e bën sektorin privat në Kosovë më të pafavorshëm ndaj konkurrencës që vjen nga jashtë dhe kjo mund të përcillet me pasoja të tjera, siç janë: ulja e prodhimit dhe e numrit të punëtorëve”, theksohet në reagimin e DhTIK-së.

Vonesa e formimit të institucioneve dëmton ekonominë, Zeka kërkon stabilitet politik dhe dialog efektiv



PRISHTINË, 16 MARS - Vonesat në formimin e institucioneve të reja, siç janë Kuvendi dhe qeveria, kanë një ndikim të dëmshëm mbi sektorin privat dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Kështu thotë drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, derisa nënvizon se edhe çështja politike e pazgjidhur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vijon të jetë problemi më i madh për vendin tonë, raporton KosovaPress. Zgjedhjet parlamentare në Kosovë u mbajtën më 9 shkurt. Partia e parë nga këto zgjedhje ka dalë Vetëvendosje, e dyta PDK, LDK e treta dhe koalicioni AAK-Nisma, i katërti. Pas publikimit të

rezultateve përfundimtare, pritet edhe certifikimi i tyre nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve(KQZ). Në një intervistë për KosovaPress, Zeka thotë se investitorët, si ata të brendshëm ashtu edhe ata të jashtëm, kërkojnë një stabilitet politik dhe një pushtet ekzekutiv dhe legjislativ të qartë për të siguruar një mjedis të favorshëm për investime dhe zhvillim ekonomik. “Investitorët e brendshëm dhe të jashtëm kërkojnë stabilitet politik, qartësi rregullative dhe kërkojnë një pushtet ekzekutiv dhe legjislativ me të cilin mund të punojnë, mund t'i ndajnë shqetësimet e

tyre dhe tek të cilët mund t'i ofrojnë edhe rekomandimet e tyre, që të njëjtat të mund të përmirësohen ose zbatohen pastaj. Çfarëdo vonesa në konstituimin e Kuvendit dhe krijimit të qeverisë së re do të ishte problematike edhe për ndërmarrjet e sektorit privat dhe për ekonominë e vendit në përgjithësi”, thotë Zeka. Zeka nënvizon se çështja politike e pazgjidhur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vazhdon të mbetet një nga problemet kryesore që pengon progresin e Kosovës, duke ndikuar, siç thotë ai, në zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Cilësia e derivateve, MINT dhe Dogana, marrëveshje për kalimin nga laboratorët privatë tek ata shtetërorë

Prishtinë, 16 mars - Me qëllim të lehtësimit të tregtisë, parandalimit të monopolizimit dhe shmangies së kostove të larta të testimeve laboratorike për kontrollin e cilësisë në tregun e brendshëm, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) dhe Dogana e Kosovës kanë nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi (MoU). Në njoftimin e bërë për medie thuhet se kjo marrëveshje garanton që testet laboratorike

do të kryhen pa asnjë barrë financiare për buxhetin e MINT-it apo bizneset, duke siguruar transparencë dhe integritet në këtë proces dhe duke përmirësuar standardet e kontrollit të cilësisë. “Që nga vendimi i Ministres së MINT, Rozeta Hajdari, Dogana e Kosovës ka marrë përsipër kryerjen e testimeve laboratorike për të garantuar konformitetin e derivateve të naftës të importuara në Kosovë. Me kalimin nga laboratorët privatë

në laboratorët shtetërorë, kemi arritur ta kursejmë ekonominë e Kosovës dhe qytetarët nga kosto të panevojshme prej 1.1 milion eurosh. Për më tepër, nga nëntori i vitit 2021 për herë të parë kemi nisur kontrollin e cilësisë për vajrat motorikë dhe hidraulikë. Që atëherë laboratorit i Doganës së Kosovës ka kryer testime për 910 mostra të vajrave, prej të cilave 78 nuk i kanë përmbyshur standardet dhe janë ndaluar nga hyrja në treg”, thuhet në njoftimin e Doganës.



DEMONSTRATAT E VITIT 1981 NË KOSOVË, SIPAS REVISTËS GJERMANE “DER SPIEGEL (3)

SI JUGOSLLAVIA PËRNDIQTE KUNDËRSHTARËT E SAJ NË KOSOVË DHE KROACI



Shkruan: Mr. sc. Naim J. KRASNIQI

Jugosllavia: Bariu ideal

“Pas shtypjes së kryengritjes në Kosovë, Beogradi dëshiron të qetësojë Republikën e Kroacisë: përmes arrestimeve”. Mes materialeve të dërguara, është edhe një raport që flet për ndjekje drejtuar SPIEGEL-it. Në atë raport flitej për rastin e Marko Veseliç, se si e kishin arsyetuar akuzën në Gjykatën e Zagrebit.

“Zora Heger është e verbër, Zdenka Grković është e paralizuar. Megjithatë, policia sekrete jugosllave në Zagreb i ftoi të dyja gratë mbi 80 vjeçare disa herë, njërën e verbër dhe të shtrirë në një shtrat. Ato duhet të dëshmonin në një proces kundër Dr. Marko Veseliç, 45 vjeç, i cili akuzohej për ‘propagandë armiqësore’, të bërë në ‘organizata në shtypin e huaj’. Bëhet fjalë për një intervistë me televizionin suedez dhe një raport të drejtuar SPIEGEL-it, të cilin SPIEGEL nuk e kishte publikuar. Veseliç, djali i një partizani të rënë gjatë luftës që e ka udhëhequr Tito-ja, ka qenë 18 vjet anëtar i Partisë, funksionar sindikalist dhe më vonë deputet i kryeqytetit të Kroacisë, në Zagreb, si dhe në Parlamentin në Beograd (është fjala për Kuvendin Federativ – N.K.). Ai kishte rënë në prizmen e organeve të Sigurimit që nga vitet ’60, ku

paraqiti tezën e tij se Jugosllavia duhet të shkatërrohej nëse Beogradi vazhdonte t’u merrte fitimet republikave që në ekonomi janë më të suksesshme si Kroacia dhe t’i transferonte ato në rajonet më të pazhvilluara të Jugosllavisë. Për këtë mendim, Veseliç u arrestua në vitin 1972 si ‘nacionalist kroat’, pas kërkesës personale të Titos, duke u dënuar me shtatë vjet burg. Në tetor të vitit 1977, ‘Amnesty International’ e shpalli atë ‘Të burgosurin e muajit’, dhe ai u lirua shpejt pas kësaj. Veseliç raportoi për SPIEGEL-in për periudhën e tij të burgimit: ‘Përllogaritet se atëherë në Kroaci rreth 32,000 njerëz ishin ndjekur, diskriminuar ose torturuar. Në burgun Stara Gradiška, ku më mbyllën, kishte shumë rrahje’. Pjesa më e madhe e mbikëqyrësve në ‘Shtëpinë e Dënimit dhe Edukimit’ Stara Gradiška përbëhej në 90% nga serbë, të cilët ‘i urrenin pa masë kroatët e burgosur’, ndonëse mëkat i vetëm i viktimave të tyre ishte ‘të jetonin në Kroaci, e cila deri më sot nuk ka të drejtën të flasë për veten dhe marrëdhëniet e saj me të tjerët, dhe duhet të pranojë pasivisht diktatin e Partisë dhe të një shteti, ndaj të cilit nuk ka kundërshtim’. Në shkurt, ai u dënua me tre vjet burg për dhënien e disa intervistave për gazetarë të huaj, përfshirë edhe intervistën e dhënë për gazetarin e ARD-së, Peter Miroschnikoff, i cili u përjashtua nga puna. Ndërkohë që rajoni i Kosovës në jug të Jugosllavisë nuk mund të vizitohej nga gazetarët e huaj që nga trazirat e mëdha të shqiptarëve, opozita në Kroaci ka qenë e izoluar nga publiku ndërkombëtar që nga vdekja e Titos: Korrespondentët francezë, të cilët dëshironin të



Pamje nga gatishmëria e demonstruesve për realizimin e kërkesave të tyre dhe nga ana tjetër rrethoja ushtarake – policore e regjimit¹⁹⁵

flisnin me mbështetësit e lënë nga ‘Pranvera Kroate’ e vitit 1971, janë akuzuar dhe kërcënuar si ‘spiunë’, janë ndaluar nëpër rrugë ose janë tërhequr nga avioni, ndërsa intervistat e tyre janë konfiskuar. Kundër studentit Dobroslav Paraga u zhvillua një gjykim javën e kaluar, sepse ai kishte dërguar një peticion të fshehur nga Partia të 43 intelektualëve të njohur kroatë në ‘Der SPIEGEL’. Ata ishin nënshkruar edhe nga ish-gjeneralë partizanë, përkrah përfaqësues të Kishës: Ata kërkonin një amnisti për të gjithë të burgosurit politikë. Nënshkruesi Ernest Brajder u arrestua vitin e kaluar dhe vdiq në burg. Paraga, bashkëvuajtes që ishte 20 vjeçar, duhet të dëshmonte se Brajder kishte kryer vetëvrasje”. Kështu ky artikull përshkruante torturat dhe ndjekjet që

ndodhnin në Kroaci, ata paralajmëronin për kalvarin që do të ndodhte në Kosovë. Edhe pse për të burgosurit kroatë kishte interesim nga organizatat për të drejtat e njeriut, si dhe nga Caritasi që bashkëpunonte me Kishën, për Kosovën ishte diçka tjetër. Ishte paralajmëruar edhe vizita e Papës Wojtyła nga fundi i vitit, që analisti thotë se: „Papa polak, Wojtyła, i cili vjen nga një zonë pranë Krakaut në Poloni, e njohur si ‘Kroacia e Bardhë’ – sepse këtu, para 1300 vjetësh, u vendosën sllavët që më pas migruan drejt Adriatikut. Papa sllav theksonte shpesh këtë lidhje të largët dhe do të pritej nga Kryepeshkopi Kuhariç dhe Kryeredaktori Kustiç”. Kryeministri i Jugosllavisë, Gjukanović, gjatë vizitës së tij në Republikën Federale (të Kroacisë – N.K.) në shkurt 1981, madje akuzoi Caritas-in si “qendër të një qeverie të mërguar kroatë” – sepse ajo ofronte ndihma për punëtorët, emigrantët dhe refugjatët politikë kroatë.

Ashtu si në Kosovë, studentët dhe mësuesit në Kroaci po ankoheshin për situatën e tyre ekonomike dhe shpirtërore: Studentët braktisën sallën kur Ministri i Kulturës së Kroacisë, Shuvar, fliste; dymbëdhjetë herë në tre muajt e parë të vitit, punëtorët kroatë hynë në grevë, sepse “standardi i jetesës në Jugosllavi ra me nëntë përqind në vitin 1980 dhe mund të rriten edhe më shumë vështirësitë ekonomike”. Partia reagon ashtu si në Kosovë (ku tani është shkarkuar kreu i partisë): me dezinformata dhe me dhunë.

Megjithatë, për momentin mbahen kthehen të vjetër, d.m.th. kuadrot që ishin demaskuar me rastin e largimit të Rankoviçit.

Kjo revistë përsëri merret me problemet e emigracionit kroat dhe pasojat që reflektonin në Perëndim, e posaçërisht në Republikën Federale të Gjermanisë, ku jetonin edhe emigrantët shqiptarë që tani nga pushteti jugosllav ishin shpallur si forcat kryesore që kanë për qëllim ndarjen e territorit të Kosovës dhe ta bashkonin me Shqipërinë. Në artikullin 2 Gushtit të vitit 1981, autori trajton temën e vrasjes së emigrantëve nga UDB-ja jugosllave, por sipas shumë gazetarëve dhe analistëve gjermanofonë, organet shtetërore gjermane heshtnin dhe nuk zbuloheshin vrasjet. Artikulli fillon me seancën gjyqësore në Landin Saarbrücken.

Kroatë: Duhet të gjuajnë

“Një gjykatës sulmon qeveritarët në Bonn dhe Beograd për faktin se ata po vëzhgojnë, pa bërë asgjë, luftën e vrasjeve midis kroatëve në mërgim dhe të dërguarve jugosllavë në territorin gjerman”. (Është fjala për agjentët e UDB-së). Në këtë kontekst, gjykatësi po i drejtohej papërgjegjshmërisë të autoriteteve të dy shteteve që, ndërsa janë të vetëdijshëm për luftën e fshehtë që zhvillohet dhe operacionet që ekzekutohen nga vrasës të dërguar nga shërbimet sekrete jugosllave, po bëjnë sikur nuk ekziston një problem i tillë,



Faksimil Gazetes „Stuttgarter Zeitung“

duke i lënë të vrasin dhe të veprojnë në terren pa ndërhyrë. Ata përpiqen të minimizojnë këtë luftë të përgjakshme dhe të fshehtë, duke e mohuar realitetin dhe duke krijuar një ndjesi të “pages” që është vetëm sipërfaqësore.

Por në këtë gjykatë po trajtohej “përplasia ndërmjet miqve dhe kundërshtarëve të regjimit jugosllav, mes atyre që luftonin për një Kroaci të pavarur, të ndarë nga Jugosllavia, dhe mbrojtësve të shtetit të Bashkuar të Beogradit, ishte gjithashtu e pranishme gjatë procesit në sallën 38. Gjatë dhjetë ditëve të gjyqit në Saarbrücken, pjesërisht me përjashtimin e publikut, u shqyrtuan praktikat e policisë sekrete jugosllave ‘Sluzba Državne Bezbednosti’ (SDB, dikur ‘UDB-a’ – Shërbimi i Sigurimit Shtetëror) dhe veprimi i saj në Republikën Federale të Gjermanisë. ‘Një gjë e tillë nuk mund të pranohet’, mërmëriti gjykatësi kryesues Franz Priester gjatë arsyetimit të dënimit, ‘që në territorin tonë të ekzekutohen urdhëra për vrasje të dhëna nga shtete të huaja për të zgjidhur problemet e tyre të brendshme’. Kritika e gjykatësit ishte drejtuar jo vetëm ndaj të akuzuarve në proces, por edhe ndaj politikanëve. Pasi në sallën e gjyqit në Saarbrücken u zbuluan gjatë operacioneve hetimore për këto vrasje (të drejtuara nga shteti jugosllav) në territorin gjerman, dy politikanë të njohur të të dyja shteteve bënë sikur nuk ekzistonte një luftë e tillë sekrete me vrasës kroatë që vepronin kundër shërbimit sekret të Jugosllavisë në territorin perëndimor të Gjermanisë”.

Se ekzistonte një bashkëpunim mes organeve shtetërore të Gjermanisë dhe atyre jugosllave për të likuiduar kundërshtarët dhe “armiqtë” e Jugosllavisë, po përmend dy të dhëna mjaft thelbësore. Një e dhënë është përmendur në “Der Spiegel”. “Në liqenin Starnberg-gut (gjendet në jug-perëndim të Mynihut – N.K.), Ministri i Jashtëm gjerman Hans-Dietrich Genscher dhe kolegu i tij jugosllav Josip Vrhovec e siguruan njëri-tjetrin se ‘nuk ka asnjë çështje bilaterale të hapur në një mënyrë dramatike’ mes Bonit dhe Beogradit”.

Po ashtu, në gazetën “STUTTGARTER ZEITUNG”, e datës 24 Mars të vitit 1981, në faqe 2, botohet një informacion (i dhënë nga Zëdhënësi i kësaj Ministrie – N.K.) për vizitën e Ministrit të Punëve të Brendshme të Jugosllavisë, Franz Herlijovic dhe takimit të tij me Ministrin e Punëve të Brendshme të RF të Gjermanisë, Gerhart Bauman, në kryeqytetin e Gjermanisë, Bon. Sipas zëdhënësit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Gjermanisë, në këtë takim ishte biseduar për

luftën e përbashkët kundër grupeve terroriste të ashtuquajturave “Balkan – Route” (...).

Dëshmi tjetër se Sigurimi Shtetëror Jugosllav ndiqte dhe vriste emigrantët që zhvillonin veprimtari anti-jugosllave, e posaçërisht kundërshtimin e politikave serbe që zbatonin kundër kombeve dhe kombësive të tjera, këto aksione i merrnin në emër të Jugosllavisë, është edhe një dokument (që e kam pasur në dorë), në Bayerische Hauptstaatsarchiv (Arkivi Qendror i Republikës (Landit) të Bavarisë), në Mynih. Në atë dokument përshkruhet një situatë ku, siç thuhet: “Demonstrimin (...) për lëvizje që kishin pikëpamje komuniste, ku dominonte emigracioni jugosllav, por që nuk karakterizohej me ndonjë manifestim të hapur ideologjik, vetëm se në një demonstrim të grupeve komuniste tek të huajt (...)”. (Citohet në raport), se ishin parë parulla ku lartësohej figura e Mao Ce Dunit dhe Enver Hoxhës, përfundon raporti i Komisarariatit Qendror të Policisë së Mynihut. Raporti vazhdon: “...me datën 10 shkurt të vitit 1966, (diku nga mbarimi i protestës), patrullat e zakonshme të policisë që po bënë mbikëqyrjen e protestës, vërejtën dy persona që fotografonin dhe iu bënë një kontroll rutinë, ku këta persona nuk kishin dokumente të identifikimit dhe i dërguan në komisarariat, ata u deklaruan se ishin jugosllavë. Komisariami njoftoi Konsullatën jugosllave, duke i lënë në mbajtje. Por të nesërmen ata ishin liruar me arsyetimin se këta ishin punonjës të Sigurimit të Konsullatës. Për policin ky nuk ishte argument që ata të mos identifikoheshin në polici, po më vonë u informuam me arsyetimet që vinin (nga organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Bavarisë si dhe

Prokurorisë...”, (për më shumë shih “Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë në shtypin gjerman”, N. Krasniqi).

Siç shihet nga këto 3 fragmente, mund të konstatohet se ka ekzistuar një bashkëpunim ndërmjet këtyre dy shteteve, por që më vonë, kur Sigurimi Shtetëror i Jugosllavisë filloi me vrasjen e disa emigrantëve kroatë dhe shqiptarë, institucionet gjermane u dolën me probleme në proceset gjyqësore nëpër vendet ku ndodhnin këto vrasje (sidomos mendoj se pas vrasjes së Vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës), që ishte një nga vrasjet më makabre ku mbetën tre persona të vrarë, por edhe kishte filluar ndryshimet shoqërore dhe politike nëpër kampin e Lindjes, si dhe reagimet e shtypit se të gjitha këto vrasje mbetën pa autorë, atëherë institucionet gjermane reaguan dhe kërkuan nga Jugosllavia që t’i ndërpriste këto veprime sepse po u sillnin probleme në sistemin juridik. Për të dëshmuar këtë po japim një fragment të “Der Spiegel”, të datës 2 Gusht të vitit 1981, ku përshkruhet një seancë gjyqësore në Saarbrücken: “...Ndërkohë, në sallën e gjyqit në Saarbrücken, askush nuk hezitoi të thoshte ‘fjalën e vërtetë’ dhe të sulmonte ‘prapa skenave, ata në pozita të larta shtetërore,’ tha (avokati Arno Walter)“. Duke vazhduar se: Nuk mund ta bëni kaq të thjeshtë”, ky avokat u zëvendësua me avokatin Walter Klein, por edhe ky vazhdoi: “...nuk mund të lejojmë një prokuror të Prokurorisë së Saarbrücken të heqë kështjellën nga zjarri”. Boni dhe Prokuroria e Përgjithshme në Karlsruhe e kishin minimizuar rastin në mënyrë të papërgjegjshme dhe thuajse e kishin fshehur në provincë (Land). Pas këtyre reagimeve të forta të avokatëve, procesi nxori këtë vendim:

“Adam Lapcevic, 23 vjeç dhe Friedrich Huber, 23 vjeç, u dënuan për tentativë vrasje me dënime 8 dhe 14 vjet burg. Jugosllavi Dragan Barac, 40 vjeç, do të vuante 13 vjet në burg. Ky trio kishte tentuar në dhjetor 1980 të vriste kasapin Franjo Goreta (SPIEGEL 13/1981), një ish-agjent të UDB-së, i cili kishte përfunduar vetë në listën e shënjestrave të grupeve të vrasësve jugosllavë”.

Për shkak të ndjeshmërisë së procesit, “Kryetari i trupës gjyqësore Priester, kërkoi që pjesa e vendeve ku kishte publik për të dëgjuar të kontrollohej dhe se salla do të kontrollohej për aparatura të spiunimit nga shërbimi sekret i Beogradit, para se Barac të pohonte gjatë procesit: ‘Kam marrë në të vërtetë urdhrin nga qarqe të larta qeveritare për të vrarë eksil-kroatin (refugjatin) Franjo Goreta’ “. Barac, sipas dëshmisë së tij, kishte udhëtuar me pasaportë false dhe biletë fluturimi falas, nën mbikëqyrjen e UDB-së, midis Gjermanisë Perëndimore dhe Jugosllavisë. Ai përmendi emra të njohur të personave të lidhur me këtë komplot, duke përfshirë një “Boris” nga Omish (qytet afër Split-it), një “shef nga Split”, një “Dimit(ri)a Sijan” dhe “Zëvendësministër të Çështjeve të Brendshme të Kroacisë”. Ata i kishin ofruar atij një milion dinarë (rreth 70,000 marka) si shpërblim për vrasjen: “Unë isha ndërmjetës mes urdhëruesve dhe ekzekutorëve”.

Kur ai arriti të bindi Huber (gjerman) dhe Lapcevic për planin e vrasjes, Barac e kryente vetëm rolin e drejtuesit të prapavijës. Ai u dha udhëzime të detajuara për viktimmën, të cilën e përshkroi si një kasap të madh dhe të fuqishëm: “Nëse nuk mund të godasësh me thikë, atëherë duhet të gjuash me armë.” Barac konfirmoi edhe një herë planin me telefon me ata që kishin dhënë urdhrin dhe

kontrolloi gjithashtu nëse çështja e shpërblimit ishte e rregulluar: secili prej atentatorëve do të merrte një të tretën e 100,000 markave, ndërsa Barac do të merrte një “pozitë të mirë shtetërore” në bregun Adriatik.

Kryegjyqtari Priester, me neveri, tha: “U punësuan si vrasës, dhe e gjetën vrasësin për të ekzekutuar urdhrin – kjo është forma më e keqe e lakmisë”. Kur më 1980, një të shtunë në Advent, shpërthyen plumba përpara derës së apartamentit të Goreta në Saarbrücken, kasapi u fut në dhomën e gjumit dhe reagoi me guxim duke gjuajtur mbrapsht. Vrasësit Huber dhe shoku i tij Lapcevic ikën, ndërsa Lapcevic u plagos në mushkëri.

Avokati Arno Walter, i cili përfaqësoi sulmuarin Goreta dhe gjithashtu ishte një socialdemokrat si Goreta, i cili gjatë fjalimit të tij kritikoi Kryeprokurorin e Përgjithshëm Kurt Rebmann dhe “përgjegjësit tanë në politikën e jashtme dhe të brendshme”. Për avokatin është e paqartë se si prokurorët kanë qenë gjithmonë të gatshëm të ndërhyjnë “edhe për grafite me simbole naziste të djathta dhe parulla të majta, ndërsa injorojnë terrorizmin e organizuar dhe të drejtuar nga agjentët e Beogradit”. Përfundimisht, siç tha Walter, “Zëvendësministrat”, që “lëshojnë urdhra vrasjeje dhe i paguajnë ata me buxhetin e shtetit”, ata duhet të akuzohen dhe dënohen për tentativë vrasjeje.

Të dy këta artikuj përshkruajnë ndjekjet dhe vrasjet e emigrantëve kroatë, përkatësisht kjo analizë po thuajse po paralajmëronte se një gjë e tillë do të ndodhte edhe me shqiptarët që ishin aktivë në luftën e tyre kundër propagandës jugosllave. Dhe siç dihet edhe ashtu, filluan vrasjet e aktivistëve politikë të emigracionit që ishin më aktivë”. **(Vijon)**





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Foda e fton Qëndrim Zybën

PRISHTINË, 16 MARS - Përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës, Franco Foda ka ftuar për dy ndeshjet e ‘play-off’-it të Ligës së Kombeve kundër Islandës edhe Qëndrim Zybën. Mesfushori qendror i skuadrës

çeke, Slovan Liberec, paraprakisht ishte pjesë e listës së zgjeruar. Në këtë edicion Zyba është paraqitur në 14 ndeshje në kampionatin çek, ka shënuar një gol dhe ka asistuar një herë. Të shtunën,

ai hyri si zëvendësues në minutën e 64-t në fitoren kundër Slavia Pragës (1:0). Detajet lidhur me këtë ftesë, por edhe për listën e futbollistëve dhe pritjet e tij nga grumbullimi i këtij muaji,

Foda do t’i japë nesër në konferencë për media, e cila mbahet në orën 12:00, në hotel ‘Emerald’. Ndërkohë, stërvitjen e parë Dardanët do ta zhvillojnë në orën 17:30 në Kampin Nacional në Hajvali.



Ylli shkëlqen në kryeqytet, Peja mposhti Borën

“Epoka e re”

PRISHTINË, 16 MARS - Golden Eagle Ylli shënoi fitore bindëse ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 62:85 (10:20, 18:18, 14:26, 20:21), në javën e 24-t të ProCredit Superligës. Për Yllin ishte fitorja e dytë radhazi pas asaj ndaj Trepçës, derisa humbja e parë për prishtinasit pas nëntë fitoreve radhazi. Mysafirët e nisën ndeshjen për mrekulli, me një seri të jashtëzakonshme prej 0:12, derisa çerekun e parë e fituan 10:20. Epërsinë më të lartë e arritën në fillim në periudhës së dytë, 19 pikë, 12:31, megjithatë bardhekaltrit u rikthyen paksa, ku skuadrat shkuan në pushim me rezultat 28:38. Por, Ylli vazhdoi me lojë të mirë në

periudhën e tretë, dhe atë të fundit, duke thelluar epërsinë për të fituar në fund bindshëm 62:85. Rashid Mahalbasiq kishte 13 pikë te vendasit, kurse te mysafirët u dalluan Jalen Nesbitt me 18 pikë, 15 kërcime e pesë asistime, Lis Shoshi me 15 pikë e gjashtë kërcime dhe Jan Palokaj me 16 pikë e shtatë kërcime. Sigal Prishtina ka 15 fitore e nëntë humbje, ndërsa Golden Eagle Ylli 11 fitore e 13 humbje. Peja regjistroi fitoren e tretë radhazi. Verdhezinjtë fituan ndaj Borës me rezultat 79:68 (18:13, 21:17, 17:16, 23:22), në javën e 24-t të ProCredit Superligës së Kosovës në basketboll. Pas një fillimi të baraspeshuar, vendasit kishin deri në shtatë pikë epërsi 18:11, derisa çereku i parë përfundon 18:13. Verdhezinjtë për një



nuancë ishin më të mirë edhe në periudhën e dytë, 21:17, për të shkuar në pushim me rezultat 39:30. Lojë më e barabartë u zhvillua në periodën e tretë, 17:16 dhe në atë të fundit, sidoqoftë, verdhezinjtë shkuan drejt fitores së tretë radhazi, duke fituar 79:68. Benas Griciunas kishte 13 pikë e 12 kërcime te vendasit, derisa Alex Lomax te mysafirët shënoi 16 pikë. Pas 24 ndeshjeve, Peja numëron 13 fitore e 11 humbje, kurse Bora tetë fitore e 16 humbje. Ndërsa, Trepça edhe pse ishte duke humbur deri në 14 pikë ndaj Vëllaznimit, arriti që në fund të triumfojë me rezultat 63:59 (8:20, 17:17, 20:14, 18:8). Bashkimi fitoi derbin e qytetit ndaj Proton Cable Prizrenit me rezultat 83:70 (27:20, 11:23, 31:5, 14:22).

Llapi triumfon ndaj Suharekës, Feronikeli 74 dhe Malisheva ndajnë pikët



PODUJEVË, 16 MARS - Java e 25-të e Albi Mall Superligës së Kosovës në futboll është përmbyllur me dy duele interesante, që u zhvilluan të dielën, ku Llapi ka shënuar fitore ndaj Suharekës, ndërsa Feronikeli 74 dhe Malisheva i ndanë pikët.

Në stadiumin “Zahir Pajaziti” në Podujevë, skuadra vendase ka shënuar fitore tejet të rëndësishme në garën për t’iu shmangur zonës së rrezikshme, duke e mposhtur Suharekën, me rezultat 2:0.

Golat e fitores për llapjanët i realizoi Ardit Tahiri, fillimisht në minutën e 32-të për epërsinë 1-0, e më pas në minutën e 82-të për ta vulosur rezultatën përfundimtar 2-0. Pavarësisht se Llapi mbeti me një lojtar më pak pas përjashtimit të Ramadanit me karton të kuq në minutën e 43-të, skuadra llapjane arriti ta menaxhojë mirë lojën dhe të sigurojë tri pikë të rëndësishme. Tani Llapi ka 29 pikë dhe e zë vendin e tetë, derisa Suhareka është një

pozitë më poshtë me pikë të njëjta. Ndërkohë, në stadiumin “Rexhep Rexhepi” në Drenas, Feronikeli 74 dhe Malisheva u ndanë baras, pa gola. Një nga mundësitë më të mira për gol i takoi Drilon Hazrollajt të Malishevës në minutën e 6-të, por ai nuk ishte i saktë nga pika e bardhë. Malisheva pas 25 ndeshjeve të zhvilluara ka 41 pikë dhe renditet në pozitën e tretë. Ballkani e mban pozitën e dytë mDe dy pikë më shumë. Feronikeli 74 mbetet i fundit me 14 pikë.

Barcelona fitore spektakolare me përmbyse ndaj Atleticos

Madrid, 16 mars - Përmbyse e pabesueshme e Barcelonës në ‘Metropolitani’, përballë Atleticos së Madridit, ku nga 2-0 e ktheu rezultatën në 4-2. Kjo fitore e jashtëzakonshme mund t’i vlejë titullin ekipit të Hansi Flick, që edhe pse me një ndeshje më pak ruan kryesimin, por me të gjitha

moralin për ta përmbyllur me sukses rrugëtimin e gjatë në kampionat. Pjesa e parë u mbyll me epërsinë e vendasve, që realizuan pikërisht pak çaste para se kryesori t’i dërgonte skuadrat në dhomat e zhveshjes për pushimin mes pjesëve. Në pjesën e dytë Barcelona e rriti

presionin në gjysmëfushën e Atleticos, por u ndeshua në kundërsulm nga Sorloth, që i çoi shifrat në 2-0. Një magji e Robert Lewandowskit vetëm dy minuta më vonë rihapi ndeshjet, ndërsa në të 78-tën erdhi edhe goli i dytë i Barcelonës, i shënuar nga Ferran Torres. Momenti

kulminant i ndeshjes ishte ai i minutës së dytë shtesë, kur Lamine Yamal, i ndihmuar edhe nga një devijim, la të palëvizur portierin kundërshtar. Por katallanët nuk e kishin thënë fjalën e fundit: Ferran Torres realizon golin e katërt prtej kohës shtesë. Përfundimisht 2-4 në



‘Metropolitano’, me Barcelonën që rikthehet në krye me golaverazh më të mirë se Real i Madridit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica
NPL - "Qendra Multifunkionale" SH.A.



Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe të gjitha aktet tjera ligjore për ndryshim plotësimet e këtij ligji, si dhe bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, "Ndërmarrja Publike "Qendra Multifunkionale" SHA shpall:

K O N K U R S

KONKURS PUBLIKË PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës: -Përgjegjës për palestër sportive (1)

-Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vitë me mundësi vazhdimi.

-Paga bazë: 474.00 (bruto)

Entiteti: NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A

Vendi: Mitrovicë

Afati për aplikim (15) ditë kalendariq nga data 17.03.2025 deri më 31.03.2025 në ora 16:00h

Përshkrim

NPL "Qendra Multifunkionale" SHA Mitrovica, është Ndërmarrje Publike Lokale në pronësi me 100% të aksioneve të saj nga Komuna e Mitrovicës. Të ardhurat e mëdha të kësaj Ndërmarrje gjenerohen nga aktivitetet e hyrje-daljeve të Ndërmarrjes NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A. është në kërkim të stafit mbështetës në Palestrën Sportive të Ndërmarrjes me kualifikim, me integritet të njohurive, përvojë të nevojshme profesionale që do të kujdesen në ndërmarrje në përputhje me parimet e njohura profesionale.

Vendi i punës: Përgjegjës për palestër sportive nr.reference 59/2025

- ◊ Diplome e nivelit Bachelor, përparësi niveli Master, drejtimi Kulturë Fizike dhe Sport,
- ◊ Përvojë në lëminë e kërkuar, minimumi 3 vite;
- ◊ Përparësi kanë personat që kanë trajnim-certifikatë në fushën e sportit.
- ◊ Aftësi të mira komunikuese;
- ◊ Të jete i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip;
- ◊ Nivel të lartë të etikes profesionale
- ◊ Të punojë në orar fleksibil dhe të jete i aftë të punojë nën presion.
- ◊

Përgjegjësitë kryesore janë:

- ◊ Koordinon orarin e termineve për Palestrat dhe Sallën Sportive;
- ◊ Ofron shërbime si trajner sportiv, mban trajnime me fëmijë, këshillon në fushat përkatëse sportive;
- ◊ Mirëmban rregullisht hapësirat kryesore të Palestrave, Sallës si dhe hapësirave të tjera ndihmëse;
- ◊ Bashkëpunon me shkollat për caktimin e termineve;
- ◊ Mban evidencën e të gjitha termineve të mbajtura;
- ◊ Ofron shërbim të shkëlqyeshëm ndaj klientëve me qëllim të krijimit të një ambienti të hapur dhe miqësor;
- ◊ Raporton tek udhëheqësit;
- ◊ Si dhe angazhohet në shërbime të tjera sipas kërkesës së mbikeqyrësit në përputhje me natyrën e punës.
- ◊ Për punën e vetë i përgjigjet Ligjit, Udhëheqësit të tij, Kryeshefit Ekzekutiv.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacioni për punë
- CV-ja
- Dëshmia mbi përgaditjen profesionale
- Certifikata e lindjes (original)
- Letërnjoftimi (kopje)
- Përvoja e punës nga lëmia profesionale(per pozitën që nevojiten)
- Vertetimi se nuk jeni nën hetime jo më të vjetër se (6) gjashtë muaj.

-Testimi dhe intervista mbahen në sallën e konferencave të NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A pas përfundimit të konkursit.

-Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen me shkrim përmes e-mailit dhe në nr. të telefonit.


-Aplikacioni merret në Administratën e NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A-Mitrovicë, si dhe dokumentet e kompletuara dorëzohen në Administratën e NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A-Mitrovicë në zaf të mbyllur.

-Dokumentet e dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrëtohen.

-Procedura e vlerësimit të konkursit publik përmban gjithsej njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik.

Për pozitën të cilat kërkohet testimi me shkrim, jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë, testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë dhe intervistimi deri në njëzetë (20) pikë

-Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në listën e ngushtë do të kontaktohen dhe ftohen për intervistë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica
NPL - "Qendra Multifunkionale" SH.A.



Na osnovu Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, i svih drugih zakonskih akata koji menjaju ovaj zakon, kao i na osnovu člana 8. Zakona br. 03/L-212 Administrativnog uputstva br.5 01/2024 o regulisanju procedura za uspostavljanje radnih odnosa u sektoru javnih preduzeća, „P“ SHA najavljuje:

K O N K U R S

Naziv pozicije: -Odgovoran za sportsku kondiciju (1)

Trajanje rada: 1 (jedna) godina sa mogućnošću nastavka.

Osnovna plata: 474.00 Bruto

Entitet: NPL "Multifunkcionalni centar" SH. A

Mesto: Mitrovica

Rok za prijavu (15) kalendarski dan od 17.03.2025. do 31.03.2025 u 16:00 sati.

Opis

NPL "Multifunkcionalni centar" SHA Mitrovica, je lokalno javno preduzeće u vlasništvu Opštine Mitrovica sa 100% akcija. Najveći prihod ovog preduzeća je generisan od aktivnosti ulaza i izlaza preduzeća. NPL "Multifunkcionalni centar" dd. traži pomoćno osoblje u Sportskoj teretani Preduzeća sa kvalifikacijama, sa integritetom znanja, neophodnim profesionalnim iskustvom o kojima će se brinuti u preduzeću u skladu sa priznatim profesionalnim principima.

Posao: Šef sportske teretane referencia br 59/2025

- ▣ Diploma, magisterij, magisterij, fizička kultura i sportaki smjer;
- ▣ Iskustvo u traženoj oblasti, minimalno 3 godina;
- ▣ Prednost imaju lica koja imaju sertifikat o obuci, u oblasti sporta.
- ▣ Dobre komunikacijske vještine;
- ▣ Budite spremni da radite sami i sa timom;
- ▣ Visok nivo profesionalne etike
- ▣ Radite fleksibilno i možete raditi pod pritiskom.
- Glavne odgovornosti su:**
- ▣ Uskladuje raspored termina za teretane i sportsku dvoranu;
- ▣ Pruža usluge sportskog trenera, održava treninge sa djecom, savjetuje u relevantnim sportskim oblastima;
- ▣ Redovno održava glavne prostore teretane, salu kao i druge pomoćne prostore;
- ▣ Saraduje sa školama na određivanju rokova;
- ▣ Vodi evidenciju o svim održanim terminima;
- ▣ Pruža odličnu uslugu korisnicima u cilju stvaranja otvorenog i prijateljskog okruženja;
- ▣ Izvještava lidere;
- ▣ Kao i angazovanje u drugim uslugama koje zahteva nadzornik u skladu sa prirodom posla.
- ▣ Za svoj rad odgovara zakonu, svom rukovodiocu, glavnom izvršnom direktoru.

Postupak prijave:

- Prijava za posao
- CV
- Dokaz o stručnoj obuci
- Izvod iz matične knjige rođenih (original)
- Pismo obavještenja (kopija)
- Radno iskustvo iz stručne oblasti (za tražene pozicije)
- Dokaz da niste pod istragom ne stariji od (6) šest mjeseci.

- Testiranje i intervju se održavaju u konferencijskoj sali NPL "Multifunkcionalnog centra" SH. Nakon završetka takmičenja.


- Odabrani kandidati će biti obavješteni u pisanoj formi putem e-maila i u br. Telefon

- Prijava se uzima u Upravu NPL "Multifunkcionalnog centra" SH. A-Mitrovica, kao i završena dokumentacija se dostavlja Upravama NPL "Multifunkcionalnog centra" SH. A-Mitrovica u koverti zatvorena.

- Dokumenti dostavljeni nakon isteka roka neće biti poderani.

- Postupak ocjenjivanja javnog konkursa sadrži ukupno 100 bodova, pri čemu je prolaznost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza javnog konkursa. Za pozicije koje zahtijevaju pismeno testiranje, životopis kandidata se ocjenjuje do deset (10) bodova, pismeno testiranje do sedamdeset (70) bodova i intervju do dvadeset (20) bodova.

Samo kandidati koji uđu u uži izbor će biti kontaktirani i pozvani na intervju.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË

NR 683

DATA 14.03.2025

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë

Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024,

Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh. A . Pejë me datë 17.03.2025, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Punëtor fizik në mbledhjen e mbeturinave - 7 pozitë

Vendi punës : Istog

Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të caktuar 3 vite

Koeficienti i pagës : 2.2

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave;

2. Mbledh mbeturinat dhe bën zbrazjen e kontejnerëve dhe mjeteve të tjera për hedhurina apo qeseve nga shfrytëzuesit e shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror;

3. Pas zbrazjes së kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdes;

4. Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve;

5. Është i obliguar të mbaj uniformën e ndërmarrjes dhe pajisjet e tjera të punës dhe mbrojtjes në punë (PPM);

6. Kryen punë bazuar në kontratën e punës por edhe punë tjera me urdhëresë të shoferit dhe kryepunëtorit;

7. Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drjtëpërdrejt, Kryeshefit Ekzkuiv

a. Kushtet e përgjithshme :

• CV;

• Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;

• Letër motivimi;

• Kopja e letërnjoftimit;

• Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

• Të ketë njohuri për shkrim dhe lexim përparësi shkollimi fillor;

• Aftësi fizike dhe psikike të dëshmuar;

• Përparësi përvojë pune e dëshmuar;

Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë

Pozita : Kryepunëtor i terrenit - 1 pozitë

Vendi punës : Istog

Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të caktuar 3 vite

Koeficienti i pagës : 2.5

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Organizon dhe koordinon punën e punëtorëve në ndrrime, cakton punëtorët dhe automjetet në kryerjen e punës së përditëshme operative në itinerarin e caktuar;

2. Mban evidencë për çdo punëtor për itinerarin e tij dhe kryen llogarinë e efektit të punës për çdo punëtor;

3. Përpilon planin ditor dhe mujor të punës në bazë të planit operativ;

4. Përcjell dhe kontrollon shfrytëzimin e kohës së punës për çdo punëtor, i evidenton dhe raportin e dorëzon në administratë dhe operative, si dhe ditarin e punëve të kryera ia dorëzon menaxherit operativ;

5. Kontrollon realizimin e detyrave ditore të punëtorëve në terren;

6. Të gjitha problemet në terren është i obliguar t'i parashtrojë me kohë të udhëheqësi i sektorit;

7. Drejtëpërdrejt kontrollon kualitetin e punës në terren dhe ua tërhek vrejtimen punëtorëve që gjatë kryerjes së punëve të mos i dëmtojnë automjetet;

8. Është përgjegjës për rregullsinë teknike dhe pastërtinë e automjetit;

9. Kërkon nga vozitësit e automjeteve që në terren të sillen korrek dhe të ndalen për grumbullimin e hedhurinave në vende të përshtatshme ku nuk pengohet komunikacioni dhe lëvizja e qytetarëve.

10. Është përgjegjës për përdorimin e mjeteve mbrojtëse në punë.

11. Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Menaxherit të Operativës, Kordinatorit Operativ;

12. Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drjtëpërdrejt, Kryeshefit Ekzkuiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

• CV;

• Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;

• Letër motivimi;

• Kopja e letërnjoftimit;

• Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

• Shkolla e mesme;

• 1vite përvojë pune e dëshmuar;

• Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com

Data e për aplikim është nga 17.03.2025 deri me 01.04.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË

NR 682

DATA 14.03.2025

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë

Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024,

Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh. A . Pejë me datë 17.03.2025, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Ngasës i kamionit - 1 pozitë

Vendi punës : Istog

Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar

Koeficienti i pagës : 2.4

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Drejton automjetin, kujdeset për rregullsinë e tij dhe është përgjegjës për ngasjen e sigurtë, duke i respektuar rregullat trafikut rrugor dhe të sigurisë;

2. Kujdeset për higijenën dhe pastërtinë e automjetit, si dhe para çdo ndezje të automjetit kontrollon gjithëmbarshtëm çdo pajisje dhe cep të automjetit dhe në momentin që vëren problem mekanik apo elektrik lajmëron kryepunëtorin, dhe nëse prishja ka ditë që nuk është rregulluar, lajmëron dhe MO, KE për problemin elektrik apo mekanik;

3. Çdo ditë merr urdhëresën e punës nga kryepunëtori dhe koordinatori operativ në të cilën e shënon evidencën e punës dhe shpenzimeve;

4. Është i obliguar që në automjet të ketë në rregull aparatin për fikjen zjarrit dhe paisjet përcjellëse të domosdoshme në komunikacion;

5. Çdo ndalje për mbledhjen e mbeturinës është i obliguar që ta bëjë sigurt dhe mundësisht në skajin e rrugës ose jashtë rrugës. Gjatë lëvizjes prapa dhe gjatë marrjes së mbeturinave me shpejtësi të vogël është i detyruar të lëshojë 4 treguesit e drejtimit dhe çdo herë për çdo veprim në trafik rrugor të jetë i sigurtë se ai veprim do të bëhet pa shkakuar incident;

6. Duhet të pajisjet me certifikatë të rregullt shëndetësore për ngasje të automjetit dhe e njëjta të jetë valide;

7. Nuk duhet të konsumojë duhan, alkool, apo narkotikë përgjatë drejtimit të automjetit, si dhe barëra të cilat kanë shenjë të trekëndëshit të sigurisë me ngjyrë të kuqe në vend të dukshëm;

8. Në rast të prishjes së automjetit me të cilin punon është i obliguar që të drejton automjet tjetër dhe kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepunëtorit, Kordinatorit Operativ;

9. Është i obliguar të menaxhoi dhe të mbaj nën kontroll ekipin e punëtorëve fizik;

10. Është i obliguar të mbajë uniformën e ndërmarrjes dhe PPM (pajisjet personale mbrojtëse);

11. Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të Kryepunëtorit,

12. Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzkuiv

a. Kushtet e përgjithshme :

• CV;

• Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;

• Letër motivimi;

• Kopja e letërnjoftimit;

• Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

• Përgatitje profesionale – Shkollim të mesëm, kategori përkatëse (C1-C);

• Përparësi përvojë pune e dëshmuar;

• Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com

Data e për aplikim është nga 17.03.2025 deri me 01.04.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË

NR 680

DATA 14.03.2025

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë

Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024,

Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë me datë 17.03.2025, shpall konkurs të brendshëm për këto vende të punës :

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita : Sigurim i Objektit (Roje) - 1 pozitë

Vendi punës : Istog

Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar

Koeficienti i pagës : 1.8

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Përcjellë hyrje-daljen e palëve, punëtorëve dhe automjeteve;

2. Daljen e punëtorëve pa leje paraprake, të parakohshme i evidenton në libër të veçant;

3. Palët duhet t'i japë fletëhyrjen dhe i orienton për në shërbimet për të cilat janë të interesuara;

4. Është i obliguar për sjellje korrekte me pale dhe për qëndrim në vendin e tij të punës;

5. Bënë sigurimin e objektit në të cilin është përcaktuar në bazë të planit mujor;

6. Bënë shqimin e gjendjes së objektit dhe mjeteve kundër zjarrit dhe rregullësis së tyre;

7. Kontrollon dhe largon personat e paautorizuar dhe të dyshimt që ndodhen afër objektit.

8. Ndërmerr masat e nevojshme në mbrojtjen e objektit nga dukurit natyrore dhe për këtë lajmëron menjëherë shërbimet e specializuara;

9. Pranon dhe dorëzon ndërrimin dhe për gjendjen e objektit e informon punëtorin e sigurimit të radhës;

10. Obligohet që në vendin e punës të mbajë uniformën;

11. Pas orarit të rregullt të punës nuk guxon t'i lejoj hyrjen e personave të pautorizuar, përveç zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes;

12. Është përgjegjës i përgjithshëm i materialit dhe automjeteve, gjatë kohës së orarit të punës, me rastin e marrjes dhe dorëzimit të detyrës;

13. Ndalon personat dhe automjetet e pa autorizuar dhe ndalon huthjen e mbeturinave nga ana e popullatës lokale;

14. Të kryej punë të cilat i besohen mbrenda ditës, të ketë kujdes në punë në mënyrë që mos të vjen gjerë te ndezja e mbeturinave;

15. Në rast të ndonjë avarie, ta evitojë atë dhe të lajmëroj shefin e sigurimit dhe organet Kompetente;

o Ndihma e shpejtë – 194,

o Emergjenca Civile – 112, 41

o Zjarrfikësit – 193,

o Policia – 119

16. Të punojë të shtunave dhe të dielave.

17. Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të shefit të sigurimit;

18. Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzkuiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

• CV ;

• Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;

• Letër motivimi ;

• Kopja e letërnjoftimit ;

• Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

• Shkollimi fillor përparësi shkollimi i mesëm;

• Përparësi janë certifikimet në siguri


• Aftësi shumë të mira organizative

• Njohja e punës me kompjuter.

• Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com

Data e për aplikim është nga 17.03.2025 deri me 01.04.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Faik Ispahiu shpall të pavlefshme diplomën e nivelit Bachelor të lëshuar më datën 20.05.2003, nr.79 në degën e artit dramatik, drejtimi regjisor, në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Diploma është lëshuar nga UNMIK-u dhe UP-ja.

- Edon Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Kadri Kusari”, Gjakovë.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



REPUBLICA OF KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

17.03.25

Thirrje e Hapur për Shërbime të Auditimit

Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të Tjerë Shëndetësorë (OIK) fton kompani audituese të paraqesin propozime për realizimin e auditimit të pasqyrave financiare të organizatës për periudhën dyvjeçare janar 2023- dhjetor 2024

- Data e Publikimit: 17.03.2025
- Afati për Dorëzimin e Ofertave është tetë (8) ditë pune nga data e publikimit

1. Rreth OIK

OIK është organizatë profesionale që përfaqëson infermierët, mamitë dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë në Kosovë. OIK është e angazhuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe zhvillimin profesional të anëtarëve të saj, duke ofruar mundësi për trajnim, përditësim të njohurive dhe mbështetje në zbatimin e standardeve më të larta në fushën e shëndetësisë.

Qëllimi kryesor i OIK është kontributi në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, si dhe promovimi i të drejtave dhe interesave profesionale të anëtarëve të saj. Përmes aktiviteteve të ndryshme, përfshirë trajnime, seminare dhe punëtori, OIK mbështet zhvillimin e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësorë, me fokus të veçantë në etikën profesionale dhe përmirësimin e kushteve të shërbimit në sektorin shëndetësor.

Për më tepër, OIK ka një rol aktiv në përmirësimin e politikave shëndetësore dhe është një nga partnerët kyç në dialogun e vazhdueshëm me autoritetet shëndetësore dhe donatorët ndërkombëtarë.

2. Objektivi i Punës / Dorëzimet

OIK fton kompanitë audituese të kualifikuara për të paraqitur propozime për kryerjen e auditimit të jashtëm, pasqyrave financiare për vitet fiskale 2023 dhe 2024. Auditimi duhet të realizohet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) dhe të ofrojë një vlerësim të besueshëm dhe të qartë të pasqyrave financiare të organizatës.

Auditimi do të përfshijë:

- Auditimin e pasqyrave financiare vjetore të OIK për periudhën 2023-2024;
- Verifikimin e saktësisë dhe besueshmërisë së raporteve financiare të organizatës;
- Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit të rrezikut.
- Identifikimin e mundësive për përmirësimin e proceseve financiare (rekomandimet).

Raportet e auditimit duhet të dorëzohen në formatin e kërkuar dhe në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratë me ofertuesin e përzgjedhur.

3. Dokumentet e nevojshme për Aplikim

Propozuesit e interesuar duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

Propozimi i Audituesit:

- Plani i auditimit – Detajet e qarta të procesit të auditimit, metodologjia e përdorur dhe orari i aktiviteteve të auditimit.
- Afati i realizimit të auditimit – Koha e kërkuar për përfundimin e auditimit dhe dorëzimin e raporteve përkatëse.
- Çmimi i shërbimit të auditimit – Shuma totale për shërbimet e ofruara, duke përfshirë TVSH-në.
- Detaje mbi ekipin auditues – Emrat dhe kualifikimet e auditorëve që do të merren me realizimin e auditit, përfshirë përvojën në auditimin e organizatave fitimprurëse dhe jofitimprurëse.

Dokumentet Mbështetëse:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit – Dëshmi për regjistrimin e kompanisë në regjistrin përkatës të biznesit.
- Certifikata e regjistrimit tatimor – Dëshmi për regjistrimin e kompanisë si subjekt tatimor.
- Licenca për shërbimet e auditimit – Licencat e nevojshme për kryerjen e shërbimeve të auditimit në përputhje me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar me afat.
- Certifikata të cilësisë dhe përvojës – Dëshmi të përvojës së mëparshme në kryerjen e auditimeve financiare për organizata jofitimprurëse ose organizata shëndetësore.
- Referenca të auditimeve të kryera – Një listë referencash nga klientë të mëparshëm, të cilët mund të ofrojnë informacione mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara.
- CV-të e auditorëve të caktuar për projektin – Informacione të detajuara mbi përvojën dhe kualifikimet e auditorëve që do të angazhohen për auditimin.

4. Udhëzime për Dorëzimin e Ofertave

- Afati për dorëzimin e ofertave: Ofertat duhet të dorëzohen deri më 26.03.2025 në ora 15:00, në formë fizike;
- Adresa për dërgimin e ofertave: Zyra e OIK, Rruga Holger Pedersen, Pristina, Kosovo, ndërtesa Vëllezërit Asllani
- Dërgoni email në info@oik-ks.org për çdo pyetje ose kërkesë të mëtejshme.

Të gjitha ofertat duhet të përfshijnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe duhet të respektojnë afatet e përcaktuara për dorëzim. Oferta që do të përbushë kërkesat dhe standardet e kërkuara do të shqyrtohet nga komisioni i caktuar i OIK.

Oferta fituese do të përzgjidhet nga Këshilli Drejtues i OIK në varësi të propozimit nga Komisioni profesional i vlerësimit në kuadër të OIK.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

